

Fier, më 17 /04/2021

KALLËZIM PENAL

KALLZUES: PARTIA DEMOKRATIKE DEGA DIVJAKË

ME OBJEKT: Kallëzim i veprës penale , Neni 248 "Shpërdorimi detyrës"
, Neni 328 "Dhenia e shperblimeve dhe e
premtimeve", Neni 328-a "Detyrimi për pjesmarrje në
veprimtari politike".

KUNDER: 

DREJTUAR: PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË LUSHNJË

I nderuar Z. Prokuror,

Bazuar në nenet 280 dhe 283, si dhe neneve 248, dhe 328 të Kodit Penal,
parashtrorjmë këtë kallzim penal për veprat penale të sipërcituar, duke
parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, provat me të
cilat vërtetohen këto fakte si dhe dispozitat ligjore penale të cënuara.

I. LIGJI I APLIKUESHEM

1.1. Kodi i Procedurës Penale, në nenet 280, 283 parashikon se:

Neni 280

Marrja dijani për veprën penale

*Prokurori dhe policia marrin dijani për veprën penale me iniciativën e vet dhe
me njoftimin e bërë nga të tjerët.*

Neni 283

Kallëzimi nga ana e shtetasve

*Çdo person që ka marrë dijani për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet
ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.*

1.2. Nga ana tjetër Kodi Penal në dispozitat e tij parashikon se: